

PROJEKTI “SHËNDET PËR TË GJITHË” (HAP)

PËRMBLEDHJE

Projekti “Shëndet për të Gjithë” (HAP) është një nismë e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e cila zbatohet në Shqipëri që prej vitit 2015 dhe synon përmirësimin e shëndetit të popullsisë shqiptare përmes një Kujdesi Shëndetësor Parësor (KSHP) më të qëndrueshëm dhe më gjithëpërfshirës. Që prej 1 prillit 2023, Instituti Zviceran i Mjekësisë Tropikale dhe Shëndetit Publik (Swiss TPH) dhe Qendra HAP po zbatojnë Fazën e Konsolidimit (Faza III) të projektit, ndërsa që nga janari 2026, HAP ka hyrë në etapën e kapitalizimit.

TË DHËNA KRYESORE



Kohëzgjatja e projektit

2015 – 2026



Donatori

Qeveria e Zvicrës përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)



Zbatuesit

Instituti Zviceran i Mjekësisë Tropikale dhe Shëndetit Publik dhe Qendra HAP



Shtrirja

20 nga 36 Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH); 11 nga 12 qarqe



Përfshirja

58% e qendrave shëndetësore kanë marrë mbështetje (208 nga 356)

KONTEKSTI – Sfidat e Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri

Popullsia

2,4 milion (të dhëna nga INSTAT, Censusi i popullsisë, 2023)



Qendra shëndetësore

356

Mjekë familjeje

1,483



Infermiere

6,636

PËRFITUESIT E PROJEKTIT



Pacientë me sëmundje kronike (përfshirë SJT-të);



Persona me aftësi të kufizuara dhe lëvizshmëri të kufizuar;



Të moshuar, veçanërisht ata që jetojnë vetëm;



Pacientë me probleme të shëndetit mendor;



Grupe vulnerabël dhe me të ardhura të ulëta.

QASJA E HAP

HAP ka zbatuar një model që synon forcimin e sistemit, duke kombinuar:



Reformën e politikave dhe qeverisjes



Rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore



Standardizimin e kujdesit



Inovacionin në ofrimin e shërbimeve (p.sh. kujdesi në banesë)

Kjo qasje synon të sigurojë përmirësime të menjëhershme të shërbimeve dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

NDËRHJRJET E HAP

1. Qeverisja dhe forcimi i sistemit

Janë mbështetur institucionet në nivel kombëtar dhe vendor për përmirësimin e menaxhimit dhe të llogaridhënies, më konkretisht:



Mbështetëm hartimin e Strategjisë së Kujdesit Shëndetësor Parësor (2020–2025) dhe vlerësimin e zbatimit të saj (2026);



Forcuar kapacitetet e Operatorit, NJVKSH-ve dhe të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;



Hartuam profile të reja pune dhe instrumente menaxheriale;



Përmirësua eficiencën operacionale të qendrave shëndetësore përmes trajnimit të drejtuesve në leadership, burime njerëzore, financa dhe komunikim;



Zhvilluam burimet njerëzore përmes programeve akademike.

2. Cilësia e kujdesit dhe standardet klinike

Është përmirësuar qëndrueshmëria dhe efektiviteti i kujdesit përmes standardizimit:



Mbështetëm hartimin dhe zbatimin e protokolleve klinike në KSHP për:

- Sëmundjet jo të transmetueshme: diabeti, hipertensioni, astma, dislipidemitë, SPOK-u
- Shëndetin mendor
- Kujdesin për të moshuarit



Hartuam udhëzues dhe manualë për ofruesit e KSHP-së.

3. Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit në banesë

Është prezantuar një model i ri kujdesi për pacientët që nuk kanë akses në qendrat shëndetësore:



Ofrohet një kujdes më i strukturuar dhe i avancuar në banesë nga infermieret për:

- të moshuarit
- pacientët kronikë
- personat e ngjuar në shtrat



Që nga viti 2022, shërbimi është shtrirë në 150 qendra shëndetësore.



Është ulur barra për familjet dhe spitalet.

4. Zhvillimi i personelit shëndetësor

Janë forcuar aftësitë, rolet profesionale dhe bashkëpunimi ndërprofesional:



Zgjeruam rolin dhe autonominë e infermiereve në KSHP;



Përmirësuam praktikat e diagnostikimit dhe trajtimit përmes trajnimeve mbi protokollet e SJT-ve;



Zhvilluam edukimin e vazhdueshëm përmes modelit kaskadë (Trajnim i Trajnerëve + Grupe Kolegësh);



Trajnuam:

- mjekë familjeje
- infermiere
- psikologë dhe punonjës socialë
- personel të NJVKSH-ve, Operatorit dhe FSDKSH-së



Mbështetëm ngritjen e programeve të Masterit në Menaxhim Shëndetësor dhe Infermieri Familjeje.

5. Integrimi i shërbimeve shëndetësore dhe sociale

Është mbështetur ofrimi i kujdesit të integruar dhe të përqendruar te pacienti:



Zhvilluam profile të reja profesionale (për psikologë, punonjës socialë);



Hartuam udhëzues për kujdes të integruar socio-shëndetësor;



Përpiluar inventarë të shërbimeve socio-shëndetësore në gjashtë bashki;



Përmirësuam koordinimin ndërsektorial.

6. Përmirësimi i infrastrukturës

Është rritur aksesin dhe cilësinë e kujdesit në komunitet:



Rikonstruktuar ose rehabilituar 31 qendra shëndetësore;



Pajisëm QSH-të me mjete mjekësore dhe paramjekësore për kujdesin në banesë;



Pajisëm mjekët e familjes dhe infermieret me çanta ekzaminimi;



Furnizuam institucionet shëndetësore me pajisje TIK

REZULTATET DHE SHKALLA E NDIKIMIT

Zgjerimi i aksesit dhe i mbulimit me shërbim



208 qendra shëndetësore kanë marrë mbështetje (~58% e totalit kombëtar);



Kujdesi në banesë ofrohet në 150 qendra shëndetësore në 20 NJVKSH dhe 11 qarqe;



Rreth 5,134 pacientë vulnerabël përfituan 89,000 vizita në banesë në vitin 2025.

Përmirësimi i cilësisë së kujdesit



Janë përmirësuar indikatorët klinikë (2015–2025);



Trajtimi për SJT-të është më i standardizuar;



Janë rritur rastet e diagnostikimit të hershëm dhe të ndjekjes;



Kënaqësia e pacientëve ka qenë vazhdimisht e lartë - mbi 85% e pacientëve shprehen të kënaqur ose shumë të kënaqur.

Forcimi i kapaciteteve profesionale



Mbi 30% e mjekëve dhe infermiereve kanë marrë pjesë në trajnime;



3,839 profesionistë janë angazhuar në Grupe Kolegësh;



1,088+ infermiere janë trajnuar për kujdesin në banesë;



Vërehet përmirësim në bashkëpunimin ndërprofesional.

Ndryshime në nivel sistemi



U hartua Strategjia e KSHP-së (2020–2025) dhe po vlerësohet zbatimi i saj;



U institucionalizua shërbimi i kujdesit në banesë;



U përmirësua menaxhimi dhe monitorimi i SJT-ve.

Kapitalizimi dhe qëndrueshmëria

HAP ka hyrë në etapën e kapitalizimit, përmes së cilës synon të shndërrojë përvojën shumëvjeçare në vlerë të qëndrueshme për sistemin shëndetësor shqiptar. Ky proces përfshin aktivitete tematike dhe analiza që:



Identifikojnë praktikatat efektive dhe sfidat ekzistuese;



Gjenerojnë mësimet për politikat dhe praktikën profesionale;



Forcojnë vendimmarrjen e bazuar në evidencë.

Ky “kapital” njohurish synon të mbështesë institucionet në përmirësimin e sistemit dhe zhvillimin e ardhshëm të kujdesit shëndetësor parësor në Shqipëri.



Shfletu
Revistën
e HAP



Rruga Themistokli Gërmenji,
Nd. Helios, Kati 2, Tiranë, Shqipëri



info@hap.org.al



health.for.all.project



www.hap.org.al



Health for All Project - HAP



Health for All Project (HAP)